

UDHËZIM
Nr. 12, datë 10.4.2014

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË (PROVIME TË LIRIMIT)
2014

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2015, “Për krijimin e IZHA-së”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) janë:
a) Gjuhë shqipe 23 qershor 2014;
b) Matematikë 27 qershor 2014.
 2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillojnë edhe Provimin e Lirimit në lëndën gjuhë amtare. Provimi i Lirimit në lëndën gjuhë amtare do të zhvillohet në datën 20 qershor 2014.
 3. Provimet e Lirimit 2014 të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.
 4. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren, “Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë (provime të lirimit) 2014”.
 5. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Gjirokastrë, Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë tezen ditën e provimit.
 6. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
 7. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
 8. Për Institutin e Nxënësve që nuk shikojnë, testi të tërhiqet në AKP nga drejtorja e institutit, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *brail*.
 9. Nxënësi mbetet në Provimet e Lirimit ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
 10. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e Provimeve të Lirimit dhe raporton për çdo parregullsi rre vërejtur në zhvillimin e tyre.
 11. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.
 12. Sektori i Statistikës i DAR/ ZA-së merr nga QVT-ja dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar Provimet e Lirimit. Këto të dhëna dërgohen në AKP, ISHA dhe MAS.
 13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Shërbimeve e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla